



DEKLARATË

Pjesëmarrja qytetare – një nevojë jetike për Programin e 100 Fshatrave

Gjatë dy muajve të fundit, **Rrjeti Shqiptar për Zhvillimin Rural (ANRD)** në përpjekje për të organizuar sektorin jopublik zhvilloi në 12 qarqet e vendit dhe më pas në katër rajonet zhvillimore, takime “Lidhja e aktorëve dhe nismave vendore për praktika të qëndrueshme në zhvillimin rural” ku morën pjesë rreth 400 sipërmarrje të ndryshme të ekonomisë rurale, përfaqësues të shoqërisë civile e të tjerë. Aktorët shkëmbyen mendime në lidhje me një organizim sa më funksional të Rrjetit Shqiptar për Zhvillimin Rural në nivel vendor me qëllim **krijimin e forumeve vendore si pjesë përbërëse e nismës së Parlamentit Rural Shqiptar**. Në këtë kuadër pjesëmarrësit dakordësuan që së shpejti të ftojnë edhe institucionet publike në nivel vendor e rajonal për t’u bërë pjesë e **Forumeve Rajonale të Zhvillimit Rural** me qëllim promovimin e agjendës për zhvillimin e qëndrueshëm rural të vendit.

Në fokus të diskutimeve të pjesëmarrësve u vunë edhe **zhvillimet më të fundit sa i takon zhvillimit rural**. U evidentua se vitin e fundit ka patur një ndjeshmëri më të lartë të institucioneve publike dhe qeverisë në ndjekjen e një agjende promovuese dhe mbështetëse për nxitjen dhe promovimin e iniciativave të ndryshme private. Po kështu është për t’u përsëritur nisma e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për hartimin e Ligjit për Organizimin dhe Funksionimin e Grupeve Vendore të Veprimit (GVV-të) që pritet të miratohet së shpejti nga Kuvendi i Shqipërisë. Ligji do të orientojë të gjitha përpjekjet e sektorit privat, institucioneve relevante publike në nivel kombëtar dhe vendor, si dhe shoqërisë civile drejt zhvillimit të qasjes LEADER dhe politikave të BE-së për zhvillimin rural.

Një çështje e rëndësishme e diskutuar në takimet e zhvilluara në të gjithë vendin ishte edhe **politika e qeverisë që njihet si Programi i 100 fshatrave**. Rrjeti Shqiptar për Zhvillimin Rural ka mbështetur që në krye të herës këtë politikë duke e çmuar atë mbi të gjitha si një mundësi për të mobilizuar resurset njerëzore në zonat rurale për zhvillim të qëndrueshëm. Pjesëmarrësit nga i gjithë vendi çmuan se përfshirja e qytetarëve, komunitetit, sektorit privat dhe shoqërisë civile në të gjitha fazat e zhvillimit të fshatit është një domosdoshmëri që nuk duhet lënë pas dore. Zhvillimi i çdo fshati në programin e 100 fshatrave duhet të udhëhiqet nga parimi i zhvillimit vendor të udhëhequr nga komuniteti. Nëse banorët nuk bëhen pjesë e vendimmarrjes lokale dhe çdo gjë vendoset nga lart, programi i 100 fshatrave mund të konsiderohet si një agjendë e interesave politike të momentit dhe mbetet larg një qasjeje gjithëpërfshirëse që çon drejt një zhvillimi të qëndrueshëm.

Rrjeti Shqiptar për Zhvillimin Rural fton **Komisionin Parlamentar për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin dhe Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural** të rikonsiderojnë hapat e deritanishëm për sa i takon zbatimit të Strategjisë Ndërsektoriale të Zhvillimit Rural, strukturës së Programit të 100 fshatrave dhe rolit mjaft të rëndësishëm që merr forcimi i kapitalit njerëzor për një zhvillim të qëndrueshëm.

Rrjeti Shqiptar për Zhvillimin Rural i bën thirrje gjithë donatorëve që mbështetja për programin e 100 fshatrave është një prioritet që duhet konsideruar, por në asnjë rast nuk duhet neglizhuar mbështetja që këto procese të jenë pjesëmarrëse, gjithëpërfshirëse, dhe të mbartin potencialin për nxitjen e iniciativës private.

Në gjashtë mujorin e dytë të këtij viti, Rrjeti Shqiptar për Zhvillimin Rural do të mbledhë **Forumet Rajonale të Zhvillimit Rural në katër rajonet e vendit** dhe do të ftojë institucionet dhe të gjithë të interesuarit për t’ju bashkuar këtij procesi për të ndërtuar një agjendë aktive deri në Parlamentin e dytë Rural të vendit.